



Financuar nga
Bashkimi Evropian



AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK



PLATFORMA E PARTNERITETIT PËR INTEGRIMIN EUROPIAN & KONVENTA KOMBËTARE PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Tryeza për Kapitullin 5 – Prokurimi Publik: Përditësimi mbi gjendjen aktuale të përmbushjes së piketave mbyllëse dhe përdorimi i inteligjencës artificiale (IA) në sistemin e prokurimit publik

E enjte, 18 qershor 2026, 10:00 – 12:00

Rekomandime

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA), në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik, organizoi më 18 qershor 2026 një Tryezë Diskutimi dhe Këshillimi për Kapitullin 5 – Prokurimi Publik, me fokus mbi përmbushjen e piketave përmblyllëse të këtij kapitulli, gjendjen aktuale të procesit, si dhe përdorimin e inteligjencës artificiale në sistemin e prokurimit publik. Aktiviteti u zhvillua në kuadër të Platformës së Partneritetit për Integrimin Europian (PPIE) dhe Konventës Kombëtare për Integrimin Europian për këtë kapitull. Nga diskutimet e zhvilluara me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, akademisë, administratës publike dhe grupeve të tjera të interesit, u identifikuan dhe u rekomanduan këto pika:

- U evidentua nevoja për hartimin e një Strategjie Kombëtare për Inteligjencën Artificiale, e cila do të shërbejë si kornizë orientuese për zhvillimin e politikave publike në këtë fushë e jo vetëm. Mungesa e një dokumenti të tillë strategjik krijon rrezik për zhvillim të fragmentuar dhe të pa koordinuar të sistemeve të inteligjencës artificiale në administratën publike, përfshirë edhe prokurimin publik.
- Në të njëjtën linjë, u rekomandua hartimi dhe miratimi i rregulloreve të brendshme institucionale që përcaktojnë në mënyrë të detajuar dhe të qartë mënyrën e përdorimit të inteligjencës artificiale në proceset e prokurimit publik. Këto rregullore duhet të adresojnë aspektet procedurale dhe funksionale të përdorimit të teknologjisë, duke specifikuar fazat konkrete të ndërhyrjes së IA-së, ndarjen e përgjegjësive ndërmjet aktorëve institucionalë dhe kufijtë e lejuar të automatizimit në vendimmarrje publike.
- U rekomandua rëndësia e përafrimit të plotë me *acquis* të BE, përfshirë zhvillimet më të fundit në fushën e inteligjencës artificiale si EU AI Act. U vlerësua se ky proces është thelbësor për garantimin e përputhshmërisë së sistemit shqiptar të prokurimit publik me standardet europiane dhe për përgatitjen e vendit drejt fazave të avancuara të procesit të integritimit.

**Tryeza e Diskutimit dhe Këshillimit për Kapitullin 5 organizohet në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.113, datë 30.08.2019 "Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin Europian".*

**Kjo tryezë zhvillohet në kuadër të projektit "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian – IPA Civil Society Facility 2021, i cili zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri dhe në bashkëpunim me Akademinë e Integritimit Europian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI).*



Financuar nga
Bashkimi Evropian



AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK



- Në lidhje me zhvillimin teknologjik, u theksua rëndësia e sigurimit të ndërveprueshmërisë së plotë të sistemeve të inteligjencës artificiale me platformat ekzistuese elektronike të prokurimit dhe me bazat e tjera të të dhënave publike. Integrimi i IA-së nuk mund të jetë funksional nëse mbetet i fragmentuar, dhe duhet të mbështetet në një sistem të integruar dixhital që mundëson shkëmbim të të dhënave në kohë reale, auditueshmëri dhe përdorim të qëndrueshëm në të gjithë ciklin e prokurimit publik.
- Zhvillimi i inteligjencës artificiale në prokurimin publik duhet të ecë paralelisht me forcimin e kapaciteteve institucionale dhe njerëzore. Vlerësohet se implementimi i sistemeve të reja teknologjike duhet të shoqërohet me programe të strukturuar trajnimi për administratën publike, përfshirë Agjencinë e Prokurimit Publik, autoritetet kontraktore dhe aktorë të tjerë që do të angazhohen në zhvillimin dhe përdorimin e sistemit. Këto trajnime duhet të fokusohen në përdorimin teknik të këtij të fundit dhe në interpretimin e rreziqeve e rezultateve dhe garantimin e vendimmarrjes së përgjegjshme.
- Gjatë diskutimeve u theksua gjithashtu nevoja për garantimin e parimit të mosdiskriminimit në përdorimin e inteligjencës artificiale, në përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë apo në vlerësimin e ofertave. Në këtë drejtim, u vlerësua e domosdoshme që sistemet të bazohen në të dhëna të verifikuara dhe të balancuara, si dhe të shoqërohen me mekanizma të vazhdueshëm auditimi dhe kontrolli njerëzor, veçanërisht në fazat kritike të vendimmarrjes. Pavarësisht automatizimit të proceseve, vendimmarrja përfundimtare duhet të mbetet gjithmonë nën kontrollin e një individi (*human oversight*), i cili garanton verifikimin, përgjegjshmërinë dhe korrigjimin e mundshëm të gabimeve algoritmike.
- U theksua se përdorimi i inteligjencës artificiale varet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga cilësia e të dhënave mbi të cilat trajnohet dhe operon. Në rastet kur të dhënat janë të paplota, të fragmentuara ose të ndikuara nga praktika problematike, ekziston rreziku që sistemet të riprodhojnë dhe të amplifikojnë të njëjtat deformime ekzistuese. Në këtë kuadër, u nënvizua gjithashtu nevoja për respektim të plotë të standardeve të mbrojtjes së të dhënave personale si pjesë e pandashme e çdo procesi dixhitalizimi.
- U theksua se qytetarët dhe operatorët ekonomikë duhet të kenë qartësi mbi mënyrën se si funksionojnë sistemet e automatizuara dhe mbi arsyetimin institucional për përdorimin e tyre. Për këtë qëllim, shihet i nevojshëm forcimi i transparencës institucionale dhe dokumentimi i proceseve vendimmarrëse, në mënyrë që përdorimi i IA-së të jetë i kuptueshëm dhe i justifikueshëm publikisht.
- Vendosja e një sistemi të qëndrueshëm të raportimit periodik mbi performancën e inteligjencës artificiale në prokurimin publik është i nevojshëm. Një mekanizëm i tillë do të

**Tryeza e Diskutimit dhe Këshillimit për Kapitullin 5 organizohet në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.113, datë 30.08.2019 "Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian".*

**Kjo tryezë zhvillohet në kuadër të projektit "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian – IPA Civil Society Facility 2021, i cili zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri dhe në bashkëpunim me Akademinë e Integritimit Evropian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI).*



Financuar nga
Bashkimi Evropian



AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK



mundësonte monitorimin e vazhdueshëm të efektivitetit të sistemit, identifikimin e kontratave apo procedurave problematike dhe përmirësimin e vazhdueshëm të funksionimit të algoritmeve. Në këtë kontekst, u sollën edhe shembuj ndërkombëtarë, ku vende të ndryshme kanë përdorur analiza pas-tenderimit për të identifikuar modele risku dhe për të forcuar integritetin e sistemit.

**Tryeza e Diskutimit dhe Këshillimit për Kapitullin 5 organizohet në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.113, datë 30.08.2019 "Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian".*

**Kjo tryezë zhvillohet në kuadër të projektit "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian – IPA Civil Society Facility 2021, i cili zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri dhe në bashkëpunim me Akademinë e Integritit Evropian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI).*